



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 gusht 2024
Nr. Ref.: RK 2489/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI95/24

Parashtrues

Marjan Komani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [ARJ.nr.161/2023] të 8 dhjetorit
2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është parashtruar nga Marjan Komani me vendbanim në fshatin Zhub, Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Ilir Nikqi, avokat në Komunën e Prishtinës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [ARJ.nr.161/2023] e 8 dhjetorit 2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [AA.nr.316/2023] e 4 korrikut 2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [A.nr.424/2020] e 2 marsit 2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës vendimin e kontestuar e kishte pranuar më 18 dhjetor 2023.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij, të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); si dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës Nr. 01/2023 së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 17 prill 2024, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij përmes postës, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) e pranoi më 24 prill 2024.
7. Më 24 prill 2024, parashtruesi i kërkesës e plotësoi me informata shtesë kërkesën e tij fillestare.
8. Më 25 prill 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KI95/24] e caktoi gjyqtarin Jeton Bytyqi Gjyqtar raportues, si dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KI95/24] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Remzie Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 2 maj 2024, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
10. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoj që të dorëzojë në Gjykatë fletë-kthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar.
11. Më 3 maj 2024, Gjykata Themelore e dorëzoi në Gjykatë fletë-kthesën e kërkuar.

12. Më 16 korrik 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Procedura administrative përkitazi me aplikimin e parashtruesit të kërkesës për përkrahje të projekteve për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2019

13. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 11 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës kishte aplikuar në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural (në tekstin e mëtejme: AZHB) për grant/përkrahje të projekteve për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2019, për masën 101.1 “*Pemë drufrutore*”.
14. Më 22 gusht 2019, AZHB përmes vendimit [Ref.AZHB 07/04/03/3512/2019] e kishte refuzuar aplikacionin e parashtruesit të kërkesës për përkrahjen nga AZHB të projekteve për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2019, pasi ky i fundit nuk i kishte bashkangjitur aplikacionit të tij kopjen fizike e digjitalizimit të sipërfaqes prej 3.60 h., të cilën e kishte marrë me qira, ashtu siç parashihej me dispozitat e nenit 6 (Përfituesit), paragrafi 5, nënparagrafi 5.14 të Udhëzimit Administrativ nr. 16/2019 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për vitin 2019 (në tekstin e mëtejme: UA nr. 16/2019).
15. Më 22 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Ministrinë e Bujqësisë, Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural (në tekstin e mëtejme: MBPZHR), duke pretenduar se me rastin e aplikimit parcela ishte e digjitalizuar dhe se AZHB nuk i kishte kërkuar atij që ta plotësonte aplikacionin me kopjen fizike të digjitalizimit. Me rastin e aplikimit ai kishte dorëzuar kopjen e digjitalizimit, me ç’rast kërkoi që ankesa e tij të trajtohet si kërkesë për rishikim të serishëm të kërkesës së tij, dhe të aprovohet përkrahja e projektit për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural për vitin 2019.
16. Më 20 janar 2020, Komisioni për vlerësimin e ankesave i MBPZHR përmes Vendimit [039/20] e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar duke konfirmuar Vendimin e lartcekur të AZHB-së të 22 gushtit 2019, me arsyetimin se kopjen e digjitalizimit ai e ka sjellë vetëm me rastin e paraqitjes së ankesës por jo brenda afatit për aplikim.

Procedura gjyqësore

17. Më 15 shkurt 2020, ndaj vendimit [Ref.AZHB 07/04/03/3512/2019] të AZHB-së të datës 22 gusht 2019 dhe vendimit të Komisionit të ankesave [nr. 039] të 20 janarit 2020, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Themelore kundër AZHB-së, duke kërkuar, ndër të tjera, që të detyrohet kjo e fundit që parashtruesit të kërkesës t’ia njoh të drejtën e fitimit të grantit për përkrahje të projekteve për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2019, për masën 101 nën masën 101.1 “*Pemë Drufrutore*”.
18. Më 2 mars 2023, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [A.nr.424/20], e refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar, ndër të tjera, se me rastin e aplikimit për grant/përkrahje në AZHB, ai nuk e kishte plotësuar të njëjtin me dokumentet e kërkuara sipas UA-se nr. 16/2019, përkatësisht nuk e kishte dorëzuar kopjen e digjitalizimit të parcelës që e kishte marrë me qira.
19. Më 13 prill 2023, parashtruesi i kërkesës ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar, ndër të tjera, se Gjykata

Themelore ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike, pasi paluajtshmëria të cilën e ka marr me qira me qëllim të kultivimit të pemëve drufrutore është e shënuar si tërësi në projekt dhe e regjistruar në AZHB.

20. Më 4 korrik 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr.316/2023] e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës duke arsyetuar se në bazë të Formularit për aplikim u vërtetua se parashtruesi i kërkesës kishte aplikuar me projektin me emër *“Përmirësimi i infrastrukturës përcjellëse për pemishten me lajthi, ne sipërfaqe 3.60 ha”*, e cila sipërfaqe ishte marrë me qira, prandaj ai është dashur të kujdeset për digjitalizimin e pjesës së marrë me qira, dhe atë para aplikimit, ashtu siç ishte përcaktuar me UA nr. 16/2019, ndërsa nga shkresat e lëndës bëhet e ditur se kopja e digjitalizimit të pjesës së marrë me qira ishte dorëzuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pra jashtë afatit për aplikim.
21. Më 1 shtator 2023, parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore paraqiti kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme, duke përsëritur pretendimet e njëjta si në ankesën drejtuar Gjykatës së Apelit.
22. Më 8 dhjetor 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ.nr.161/2023] e refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, duke arsyetuar se parashtruesi i kërkesës është dashur që para aplikimit të bëjë digjitalizimin e parcelës cilën e ka marrë me qira, ndërsa kopjen fizike të digjitalizimit t'ia bashkëngjisë dosjes së aplikimit brenda afatit të përcaktuar ligjor për aplikim, ashtu siç është përcaktuar në UA nr. 16/2019, përderisa i njëjti në seancën e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë është deklaruar se këtë dëshmi e ka siguruar më vonë dhe e ka dorëzuar me ankesë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës si dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
24. Në lidhje me pretendimin për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga ana e Gjykatave të rregullta, përkatësisht zbatim të gabuar të UA nr. 16/2019, duke theksuar se *“kinse aplikuesi e ka marr me qira parcelën me të cilën ka aplikuar për këtë grand, andaj edhe është dashur ta bëjë digjitalizimin e pjesës së dhënë me qira para aplikimit.”* Lidhur me këtë ai sqaron se parcela në fjalë *“ka qenë e digjitalizuar paraprakisht në faqen e AZHB, shumë kohë përpara, për shkak se ajo pjesë veçse ka qenë e mbjellur, i njëjti ka plotësuar të gjitha dokumentacionet e kërkuara për aplikim, ndërsa paluajtshmëria të cilën e ka marr me qira me qëllim të kultivimit të pemëve drufrutore është e shënuar si tërësi në projekt dhe e regjistruar ne NIF [Numri Identifikues i Fermerit]me sipërfaqe të specifikuar në harta zonale te cilat [...] me të cilën disponon AZHB ku edhe specifikisht në kopje fizike të hartës shënon se ky dokument është pronë e AZHB”*.
25. Më tej, parashtruesi i kërkesës thekson se dokumenti i lëshuar nga Komuna e Gjakovës *“[Nr.08/320/o 1-38807] i 16 tetorit 2019, dëshmon që dëshmia e digjitalizimit nuk lëshohet nga komuna por nga vet AZHB, andaj, duke mos ja falur besimin të njëjtit gjykatat e rregullta kanë bërë shkelje të paragrafit 1 të nenin 329 të Ligjit për*

Procedurën Kontestimore i cili në ndërlidhje me fuqinë provuese të shkresave përcakton se "Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të". Kjo dispozitë sipas parashtruesit të kërkesës është e aplikueshme në rastin konkret duke u bazuar në nenin 63 (Dispozitat e tjera të procedurës) të Ligji për Konfliktet Administrative që përcakton se "Nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore".

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat kanë dështuar që të përmbushin detyrimin kushtetues sipas nenit 53 të Kushtetutës për të trajtuar çështjen gjyqësore në kontest të praktikës relevante të Gjykatës Evropiane pasi që gjykatat e rregullta kanë bazuar vendimmarrjen e tyre duke u bazuar vetëm në UA nr. 16/2019.
27. Parashtruesi i kërkesës po ashtu thekson se sipas nenit 5.16 të UA nr. 16/2019, "ku shihet lista e dokumenteve për investimet në ferma ekzistuese me ndërtim ose zgjerim, aplikuesi duhet të dorëzoj dokumente nga pika 5.16.1 deri në pikën 5.16.6 të [UA nr.16.2019], nuk ceket se duhet të dorëzohet digjitalizimi i parcelave, andaj gjykata ka bërë zbatim selektiv të këtij udhëzimi duke mos pasur parasysh nenet e tij të lartë cekura, e me këtë njëkohësisht ka shkelur edhe nenin 6 [Parimi i barazisë dhe mos diskriminimit] Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lidhur me nenin 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës".
28. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se gjykatat e kanë mohuar të drejtën për trajtim të barabartë, pasi nuk kanë siguruar barazi sa i përket investimeve qeveritare pasi nuk patën parasysh formularin e aplikimit në të cilin përcaktohet se "[...] në mungesë të dokumentacioneve të kërkuara për aplikim atëherë aplikuesi pasi të njoftohet se ka mungesa të dokumentacioneve duke i specifikuar se cilat dokumentacione mungojnë, ka të drejte që në afat prej 5 ditësh të bëjë plotësimin e këtyre dokumentacioneve në të kundërtën e humb të drejtën për plotësim shtesë, e që në rastin konkret paditësi nuk është informuar nga ana e të paditurës që ka mungesë të dokumentacioneve përkatësisht i mungon digjitalizimi i parcelës të cilën e ka marr me qira dhe ka aplikuar, pasi që projekti nuk korrespondonte me ngritjen e një parcele të re ku do të duhej fillimisht digjitalizimi si pjesë e dokumentacionit të NIF, por ishte një projekt për ndërtim dhe plotësim të infrastrukturës së një parcele paraprakisht të mbjellur me sipërfaqe edhe të digjitalizuara përmes koordinatave, andaj edhe nuk ka vepruar me herët për plotësim të dosjes së aplikimit. E me këtë veprim e paditura i ka mohuar të drejtën për trajtim të barabartë pa diskriminim paditësit pasi që nuk i ka dhënë mundësinë për plotësim të dokumentacionit që i ka munguar pa fajin e tij pasi që i njëjti nuk ka qenë as i informuar sipas konkursit që nevojitet ky digjitalizim, andaj konsiderojmë që edhe gjykata me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë ka vepruar në mënyrë të gabuar duke mos vërtetuar faktet vendimtare në këtë çështje, siç edhe e cekem me lart duke kërkuar informacione nga AZHB e Komisionit të ankesave". Sipas tij, kjo ka rezultuar në shkelje të paragrafit 2 të nenit 9 [Parimi i administratës së hapur] dhe paragrafin 1 të nenit 11 [Parimi i informimit dhe ndihmës aktive] të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, që përcaktojnë, ndër të tjera, se (i) organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t'u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative; dhe (ii) organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që mosdija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, që ajo ka sipas ligjit.

29. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) të konstatojë shkeljen e të gjitha dispozitave të lartcekura në dëm të tij; dhe që (ii) Aktgjykimet e Gjykatave të rregullta të shfuqizohen dhe rasti të kthehet në rigjykim.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.”

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]”

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për gjykim të drejtë)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]”

Udhëzimi Administrativ Nr.16/2019 për Masat dhe Kriteret e Përkrashjes për Zhvillim Rural për Vitin 2019

Neni 6

Përfituesit

[...]

5. Kriteret e tjera të pranueshmërisë

[...]

5.14 Nëse nga një parcelë është dhënë me qira vetëm një pjesë e saj, aplikuesi para aplikimit duhet të bëjë digjitalizimin e pjesës së dhënë me qira dhe një kopje fizike të pjesës së digjitalizuar t'ia bashkoj dosjes së aplikimit.

[...]

Neni 29

Dorëzimi i aplikacioneve

[...]

6. Dosja e plotë e aplikimit dorëzohet brenda afatit të shpalljes publike në dy (2) kopje fizike dhe të gjitha dokumentet e dosjes duhet të skanohen dhe të ruhen në CD, e cila dorëzohet bashkë me kopjet fizike.

[...]

Neni 30

Pranimi/kontrollimi i aplikacioneve në Zyrat Regjionale të AZHB-së

[...]

5. Aplikuesi ka të drejtë deri në përfundim të afatit për aplikim që ta kompletojë dosjen e aplikimit.

[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

32. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 (Kërkesa individuale), nenit 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe nenit 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

33. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është: (i) palë e autorizuar; (ii) konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ.nr.161/2023] e 8 dhjetorit 2023 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [AA.nr.316/2023] e 4 korrikut 2023 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [A.nr.424/2020] e 2 marsit 2023 të Gjykatës Themelore; (iii) ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; (iv) ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj; si dhe (v) e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
34. Përveç këtyre kriterëve, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Specifikisht, pika (d) e paragrafit 1 dhe paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcaktojnë që:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

[...]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.

35. Gjykata fillimisht thekson se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih rastet e GJEDNJ-së [Kemmachev kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykim i 24 nëntorit 1994, paragrafi 44 [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005, paragrafi 55; Mentzen kundër Letonia, Kërkesa nr. 71074/01, [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008, dhe rastet e

Gjykatës [K104/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 prillit 2021, paragrafi 26; [K1107/21](#), parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 tetorit 2021, paragrafi 53; dhe [K105/23](#) parashtrues *Branislav Gajin*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2024, paragrafi 51).

36. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë si dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të saj dhe ato të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
37. Rrethanat e rastit konkret rezultojnë nga kërkesa e parashtruesit të kërkesës drejtuar AZHB-së për përkrahjen e projektit për zhvillim rural, për masën 101.1 “*Pemë drufrutore*”. AZHB e kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se me rastin e dorëzimit të aplikimit, ai nuk e kishte dorëzuar kopjen e digjitalizimit të parcelës së marrë me qira, ashtu siç kërkohet specifikisht me nën-paragrafin 5.14 të paragrafit 5 të nenit 6 të UA. nr. 16/2019. Parashtruesi i kërkesës, kundër vendimit të AZHB-së, kishte parashtruar ankesë në Komisionin e ankesave brenda MBPZHR-së, e cila ankesë ishte refuzuar. Më tej, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore, duke pretenduar, ndër të tjera, se (i) dokumenti i cili kërkohet të dorëzohej me aplikim ishte dokument i cili ishte lëshuar nga vet AZHB, prandaj kjo e fundit do të duhet të merrte këtë parasysh; dhe (ii) AZHB do të duhej të kërkonte specifikisht nga parashtruesi i kërkesës që ta plotësonte aplikacionin e tij para se të njëjtin ta refuzonte. Gjykata Themelore kishte refuzuar padinë e tij si të pabazuar duke arsyetuar se ai kishte dështuar të dorëzonte aplikacionin e tij për grant/mbështetjeje sipas kriteve të përcaktuara në UA nr. 16/2019. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.
38. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar atij iu janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenet 3, 24, 31 dhe 54 të Kushtetutës si dhe neni 6 i KEDNJ-së, për shkak se organi administrativ dhe gjykatat e rregullta nuk i kanë mundësuar një gjykim të rregullt dhe të paanshëm, si dhe pa diskriminim gjatë procedurës administrative dhe gjyqësore, për faktin se (i) parcela në fjalë me rastin e aplikimit për grant/përkrahje ishte e digjitalizuar; (ii) AZHB ishte në dijeni për këtë fakt pasi ky ishte një dokument i lëshuar nga vet AZHB; dhe (iii) ky dokument ishte dorëzuar me rastin e paraqitjes së ankesës në MBPZHR; dhe se (iv) AZHB kishte obligim që të kërkonte plotësimin e aplikacionit nga parashtruesi i kërkesës, para se të njëjtin ta refuzonte si të paplotësuar.

Përkitazi me pretendimin për shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë

39. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me aplikimin e gabuar të ligjeve dhe akteve nënligjore të zbatueshme në rastin e tij nga gjykatat e rregullta, përkatësisht UA nr. 16/2019 dhe legjislacionin që ndërlidhet me procedurën administrative.
40. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se pretendimet parashtruesi i kërkesës i ka ngritur në kuptim të 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe kanë të bëjnë me interpretimi dhe zbatim të gabuar të dispozitave ligjore nga ana e gjykatave të rregullta, dhe si të tilla bien në kategorinë e pretendimeve “*të shkallës së katërt*”, sepse ngërthejnë çështje që ndërlidhen me interpretimin dhe aplikimin e ligjit, përkatësisht “*ligjshmërisë*” dhe jo “*kushtetutshmërisë*”.

41. Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin ndërmjet “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës [KI179/18](#), parashtrues *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; [KI49/19](#), parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A., “Adem Jashari”*, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; [KI56/17](#), parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 gushtit 2019, paragrafi 60; [KI76/21](#), parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 34; [KI188/21](#), me parashtrues *Zenel dhe Isuf Pllashniku*, Aktvendim për Papranueshmëri i 19 korrikut 2022, paragrafët 98-99; [KI31/22](#), me parashtrues *Fidan Hoti*, Aktvendim për Papranueshmëri i 18 janarit 2023, paragrafët 43-44, [KI89/22](#), parashtrues *Xhelal Plakolli*, Aktvendim për Papranueshmëri i 7 marsit 2023, paragrafi 42).
42. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, *paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty*; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, [KI49/19](#), rast i cituar më lart, paragrafi 48; dhe [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), rast cituar më lart, paragrafi 61, dhe së fundmi rastiin [KI76/21](#), parashtrues *Qemajl Babuni*, rast i cituar më lart, paragrafi 35; [KI31/22](#), me parashtrues *Fidan Hoti*, cituar më lart, paragrafi 42, [KI89/22](#), parashtrues *Xhelal Plakolli*, cituar më lart, paragrafi 43).
43. Gjykata mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime mund të kenë rezultuar në konkluzione arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (shih rastin e Gjykatës [KI75/17](#), parashtrues *X*, Aktgjykim i 30 janarit 2018, paragrafi 59; dhe [KI89/22](#), parashtrues *Xhelal Plakolli*, cituar më lart, paragrafi 44).
44. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, Gjykata rikujton arsyetimin e Aktgjykimit [A.nr.424/20] të 2 marsit 2023, të Gjykatës Themelore, e cila refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Gjykata po ashtu sjellë në vëmendje arsyetimin e Gjykatës Themelore përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me digjitalizimin e parcelave tokësore të marra me qira, më ç’rast e njëjta kishte arsyetuar se “(i) me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit kontestues i’u referua dispozitës se nenit 6 paragrafi 5, nën paragrafi 5.14 të Udhëzimit Administrativ nr.16/2019 për masat dhe kriteret e përkrahjes për Zhvillim Rural për vitin 2019, me të cilën është përcaktuar: “nëse nga një parcele është dhënë me qira vetëm një pjesë e saj, aplikuesi para aplikimit duhet të bëjë digjitalizimin e pjesës së dhënë me qira dhe një kopje fizike të pjesës së digjitalizuar t’ia bashkoj dosjes së aplikimit”; (ii) përmes Formularit për Aplikim-2019 u vërtetua se paditësi për masën 101, kishte aplikuar me projektin me emër “Përmirësimi i infrastrukturës përcjellëse për pemishten me lajthi, në sipërfaqe 3.60 ha”. Sipërfaqe kjo e cila nga Plani i biznesit dhe Certifikata e regjistrimit të fermerit bëhet e ditur se është marrur me qera; (ii) aplikuesi është dashur të kujdeset për digjitalizimin e pjesës së dhënë me qera, dhe atë para aplikimit,

ashtu siç ka përcaktuar me [UA]; si dhe (iii) nga shkresat e lëndës, kopja e digjitalizimit të pjesës së dhënë me qera ishte dorëzuar jashtë afatit për aplikim, do të thotë me rastin e parashtrimin të ankesës”.

45. Arsyetimi i Gjykatës Themelore ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, sipas së cilave rezultoi se: (i) parashtruesi i kërkesës bazuar në UA nr. 16/2019 kishte për obligim që të dorëzonte kopjen e digjitalizimit të parcelës së marrë me qira, me rastin e aplikimit; (ii) ai kishte të drejtë deri në përfundim të afatit për aplikim që ta kompletojë dosjen e aplikimit, gjë që në rastin konkret ky nuk ishte rasti; (iii) parashtruesi i kërkesës kopjen e digjitalizimit e kishte dorëzuar vetëm me rastin e paraqitjes së ankesës, pra pas afatit për aplikim.
46. Gjykata po ashtu i referohet edhe në-paragrafit 5.14, paragrafit 5 të nenit 6 të UA nr. 16/2019, ku përcaktohet se: *“Nëse nga një parcelë është dhënë me qera vetëm një pjesë e saj, aplikuesi para aplikimit duhet të bëjë digjitalizimin e pjesës së dhënë me qera dhe një kopje fizike të pjesës së digjitalizuar t’ia bashkoj dosjes së aplikimit”.* Po ashtu, Gjykata i referohet edhe paragrafit 6 të nenit 29 të UA nr. 16/2019 që përcakton se *“Dosja e plotë e aplikimit dorëzohet brenda afatit të shpalljes publike në dy kopje fizike dhe të gjitha dokumentet e dosjes duhet të skanohen dhe të ruhen në CD, e cila dorëzohet bashkë me kopjet fizike”;* si dhe paragrafit 5 të nenit 30 të UA nr. 16/2019 që përcakton se *“Aplikuesi ka të drejtë deri në përfundim të afatit për aplikim që ta kompletojë dosjen e aplikimit”.*
47. Për më tepër, Gjykata vëren se bazuar në parashtruesi i kërkesës nuk i referohet ndonjë dispozite konkrete të UA nr. 16/2019 ose të ndonjë ligji dhe as nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës nuk rezultoi që organet administrative në rastin konkret kishin për obligim që të kërkojnë nga parashtruesi i kërkesës që të kompletojë dosjen e tij, nëse një gjë e tillë nuk ishte bërë brenda afateve të përcaktuara.
48. Prandaj, bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta i kanë dhënë përgjigje parashtruesit të kërkesës për pretendimet e tij për digjitalizimin e parcelës së marrë me qira duke elaboruar të drejtën materiale dhe procedurale të aplikueshme në rastin konkret.
49. Për më tepër, nga arsyetimi i konkluzioneve të gjykatave të rregullta, vërehet qartë se në dritën e rrethanave të rastit konkret, nuk kemi të bëjmë as me *“aplikim të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar”* dhe as me *“konkluzione arbitrare”* apo *“qartazi të paarsyeshme”* nga ana e gjykatave të rregullta përshirë Gjykatën Supreme.
50. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mungesën e një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm janë pretendime që bien në kategorinë e *“shkallës së katërt”* dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës.

Përkitazi me pretendimet tjera

51. Siç u cek më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme shkelë të drejtat e tij të garantuara me nenet 3, 24 dhe 54 të Kushtetutës. Mirëpo, parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend nenet përkatës, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri të shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesave duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe

argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese [KI187/18 dhe KI 11/19](#), parashtrues: *Muhamet Idrizi*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 korrikut 2019, paragrafi 73; [KI125/19](#) parashtrues: *Ismajl Bajgora*, Aktvendim për papranueshmëri i 11 marsit 2020, paragrafi 63; dhe së fundmi rastin [KI175/20](#), parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 26 marsit 2021, paragrafët 79-82).

52. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila thotë se *“diskriminimi do të thotë trajtim ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata relativisht të ngjashme”* (shih rastet e GJEDNJ-së, [Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 36042/97, Aktgjykimi i 11 qershorit 2002, paragrafi 48; [Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë](#), nr. 15250/02, Aktgjykimi i 13 marsit 2006, paragrafi 63, shih gjithashtu rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim i 5 janarit 2021, paragrafi 44).
53. Më tej, Gjykata rikujton se në mënyrë që pretendimet e parashtruesve në lidhje me shkeljen e të drejtës për mos-diskriminim të jenë të suksesshme, ata, me tjerash, duhet të dëshmojnë se pozita e tyre mund të konsiderohet e ngjashme me pozitën e një personi tjetër i cili ka pasur trajtim më të mirë (shih rastin e GJEDNJ-së [Fredin kundër Suedisë](#), nr.12033/86, Aktgjykim i 18 shkurtit 1991, paragrafi 60, shih gjithashtu rastin e Gjykatës [KI166/20](#), cituar më lart, paragrafi 45).
54. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka identifikuar grupin e personave që sipas tij janë trajtuar ndryshe, dhe ai nuk ka paraqitur asnjë dëshmi e cila do të mund të provonte se përgjatë procesit ka pasur me të vërtetë diskriminim, përkatësisht se është trajtuar ndryshe me ndonjë palë tjetër në një situatë të njëjtë ose të ngjashme e cila mund të ketë përfituar nga ndarja e drejtësisë në kushte të njëjta.
55. Thënë këtë, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve të lartcekura të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës, në të vërtetë, i ka elaboruar mbi bazën e nenit 31 të Kushtetutës duke e ndërlikuar shkeljen e kësaj të drejte themelore, me interpretimin e gabuar të dispozitave ligjore nga gjykatat e rregullta, për çfarë Gjykata, sa më sipër, konstatoi se në këtë pjesë kërkesa duhet të shpallet qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht e papranueshme, për arsyet e lartcekura.
56. Prandaj, Gjykata konstaton se përkitazi me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet e lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, Gjykata konkludon që kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë së (iii) pretendimeve *“të pambështetura ose të paarsyetuara”*, sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citoi nenet e Kushtetutës, pa shpjeguar se si janë shkelur ato. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në rregullin 34 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 34 (1) (d), dhe (2) si dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 16 korrik 2024, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe
- IV. TË KONSTATOJË që ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Jeton Bytyqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani